



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**

**Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës**

*Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force*

**Departamenti i Personelit/ Odsek za personal/Department for Personnel**

Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr.03/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-82 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2013 për Rekrutimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës shpall:

**K O N K U R S I B R E N D S H Ë M**  
**PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NË KOMPANINË PËR OPERACIONE**  
**ME CIVILËT**

<u>OF2-</u>	<u>3 pozita:</u>
<u>OR8/OR9-</u>	<u>1 pozitë</u>
<u>OR7/OR8-</u>	<u>5 pozita:</u>
<u>OR5/OR7:</u>	<u>9 pozita.</u>
<u>Njësia:</u>	<u>Kompania për Operacione me Civilët e FSK-së</u>

Ministria e Forcave të Sigurisë së Kosovës (MFSK) ushtron mbikëqyrje civile dhe kontroll demokratik mbi FSK-në dhe udhëhiqet nga Ministri i FSK-së, i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Ministria është përgjegjëse për zbatimin e politikave qeveritare për sa iu përket çështjeve që ndërlidhen me FSK-në dhe po ashtu do të veprojnë edhe si shtabi i nivelit më të lartë të FSK-së.

Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë krejtësisht vullnetare e ndërtuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës, si instrument i sigurisë është që ta mbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë janë; Të marrë pjesë në operacionet për reagim ndaj krizave, përfshirë operacionet në mbështetje të paqës. Kjo do të përfshijë operacionet jasht territorit të Republikës së Kosovës, ku do të ftohet për këtë qëllim; të ndihmojë autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore, fatkeqësive dhe emergjencave tjera, madje edhe si pjesë e një përpjekjeje reaguese regjionale apo ndërkombëtare; të kryej shkatërrimin e mjeteve shpërthyes; të ndihmojë autoritetet civile përmes operacioneve të mbrojtjes civile.

Kjo kompani do të operoj sipas doktrinës dhe konceptit operacional të Ushtrisë Amerikane dhe do të jetë e gatshme dhe në gjendje të zbues apo eliminojë cenueshmëritë e ndryshme ndaj popullatës e cila është në rrezik nga ndikimet e jashtme apo të brendshme.

**Tëstime të njohurive;**

- Testi IQ
- Matematikë, lexim, shkrim dhe zgjidhje të problemeve

**Testimet e përgatitjes fizike;**

- APFT
- Vrapime në distanca të pacaktuara
- Marshime në distanca të pacaktuara (pesha 20kg)

**Vlerësimet e personalitetit;**

- Testi Briggs Myers
- Teste psikologjike,
- Aftësia për të punuar në grupe

- Adaptimi në situata stresuse me presion të lartë,

#### **Kërkesat për aplikantët për Kursin Selektues,**

- Gjendja mjekësore, vërtetimi i nënshkruar nga doktori i FSK-së,
- Dëshmi mbi njohjen e gjuhës angleze, niveli bazik,
- Shërbimi në FSK, të paktën dy vite dhe vlerësimet vjetore për dy vitet e shërbimit,
- Tri vlerësimet e fundit vjetore për ata që kanë shërbyer më prej tre viteve e më shumë
- Verifikimi,
- Dëshmi që nuk është i ndjekur penalisht,

#### **Kriteret tjera të dëshirueshme/konsideratat shtesë;**

- Dy gjuhë që fliten në Kosovë (gjuha shqipe dhe serbe apo turke)
- Certifikata e trajnimeve ushtarake,
- Diploma dhe certifikatat për shkollimin civil,

#### **Teste paraprake (të cilat mund të realizohen nga njësitë)**

- Kalueshmëria e APFT-së brenda 30 ditëve
- Dëshmi për marshim 20km nën 3 orë e 15 minuta (brenda 6 muajve)
- I gatshëm të notoj 50 metra me uniformë (dëshmi të nënshkruar nga oficeri komandues)
- I gatshëm të qëndroj në ujë së paku 5 minuta((dëshmi të nënshkruar nga oficeri komandues)

#### **Aplikimi;**

- Për gradën OF2 të drejtë konkurrimi kanë pjesëtarët me gradë OF2 dhe OF1(duke mos përfshirë nëntogerët).
- Për gradën OR8/OR9 të drejtë konkurrimi kanë pjesëtarët me gradë OR7 dhe OR8,
- Për gradën OR7/OR8 të drejtë konkurrimi kanë pjesëtarët me gradë OR5 dhe OR7,
- Për gradën OR5/OR7 të drejtë konkurrimi kanë pjesëtarët me gradë OR3 dhe OR5,

#### **Shënim:**

- Kandidatët e përzgjedhur do të nënshkruajnë memorandum/kontratë për shërbim së paku 2 vite në Kompaninë për Operacione me Civilët nëse kalon kursin selektues dhe kualifikues.

#### **Si të aplikoni;**

Formularët e aplikimit janë në dispozicion në të gjitha njësit përkatësisht në Zyrat e Personelit, ku gjendet shpallja e konkursit. Formularët duhet të dorëzohen personalisht së bashku me kopjet e dokumentacioneve të kërkuara që dëshmojnë përmbushjen e kushteve sipas konkursit, në të gjitha zyrat e personelit të Njësive të FSK-së, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Për informata plotësuese, mund të kontaktoni zyrat e personelit.

Konkursi është i hapur prej datës **05.12.2018** dhe data e fundit e aplikimit është **19.12.2018**. Të gjitha aplikacionet e pranuar, do t'i përcillen G1KFT-së nga njësitë brenda një dite pas përfundimit të afatit të konkurrimit.

**Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës ofron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së dhe mirëpret aplikacionet e tyre, pa dallim nga përkatësia etnike apo gjinore.**